AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
NË ARSIMIN E LARTË

PLANI STRATEGJIK

2026–2030

ASCAL

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA

01 Hyrje dhe konteksti 03

02 Metodologjia 05

03 Misioni, vizioni dhe vlerat 07

04 Kuadri ligjor, rregullator dhe strategjik 09

05 Objektivat strategjikë dhe masat 10

06 Zbatimi, monitorimi dhe rishikimi 13

I. HYRJE DHE KONTEKSTI

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përbën një element themelor për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit të arsimit të lartë dhe për përmbushjen e misionit të tij publik. Cilësia e institucioneve dhe e programeve të studimit ndikon drejtpërdrejt në formimin akademik dhe profesional të studentëve, në besueshmërinë e kualifikimeve, në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, si dhe në kontributin që arsimi i lartë jep në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit. Një sistem funksional dhe i besueshëm i sigurimit të cilësisë mbron interesin e studentëve dhe të shoqërisë, forcon përgjegjshmërinë e institucioneve dhe mbështet njohjen dhe konkurrueshmërinë e arsimit të lartë shqiptar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Institucionet e arsimit të lartë, si përgjegjëse parësore për cilësinë e ofertës akademike, duhet të zhvillojnë sisteme të brendshme funksionale të sigurimit të cilësisë, të mbledhin dhe përdorin të dhëna të besueshme, të përfshijnë studentët dhe palët e tjera të interesit dhe të dëshmojnë se rezultatet e vlerësimeve shndërrohen në masa konkrete përmirësimi. Sigurimi i jashtëm i cilësisë plotëson këtë përgjegjësi, duke ofruar vlerësim të pavarur, profesional dhe të bazuar në standarde e evidenca, duke garantuar llogaridhënie publike dhe duke nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të institucioneve dhe programeve të studimit. Në këtë kontekst, sigurimi i jashtëm i cilësisë nuk mund të kufizohet vetëm në verifikimin formal të përmbushjes së standardeve, por duhet të kontribuojë në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme të cilësisë.

Zhvillimet në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), ndërkombëtarizimi, format e reja të mësimdhënies dhe të të nxënit, digjitalizimi dhe inteligjenca artificiale kërkojnë përshtatjen e proceseve të sigurimit të cilësisë. Njëkohësisht, ndryshimet demografike dhe nevojat e shoqërisë e të tregut të punës shtojnë kërkesat për arsim të lartë cilësor, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt rezultateve. Këto zhvillime kërkojnë procese vlerësimi të qarta dhe proporcionale, që respektojnë autonominë akademike dhe mbështeten në standarde e evidenca të besueshme.

01 / HYRJE DHE KONTEKSTI

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në ushtrimin e funksioneve të saj ligjore, ka përgjegjësinë për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. ASCAL e ushtron këtë mandat në mënyrë të pavarur, të paanshme, profesionale dhe transparente, në përputhje me legjislacionin kombëtar, Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, aktet rregullatore dhe procedurale në fuqi, si dhe me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG). Pavarësia në hartimin dhe miratimin e procedurave, përcaktimin e kritereve dhe formateve të vlerësimit, përzgjedhjen e ekspertëve dhe përmbajtjen e raporteve përbën kusht themelor për besueshmërinë dhe integritetin e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë.

Periudha 2026–2030 përfaqëson një fazë të re të zhvillimit institucional të ASCAL-it. Hapat e ndërmarra nga ASCAL për rishikimin e procedurave, përmirësimin e sistemit elektronik AMS, angazhimin e ekspertëve kombëtarë e ndërkombëtarë, përfshirjen e studentëve dhe zhvillimin e mekanizmave të monitorimit e feedback-ut kanë krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të Agjencisë. Periudha 2026–2030 kërkon konsolidimin e këtyre hapave, rritjen e konsistencës dhe efektivitetit të vlerësimeve, përdorimin më sistematik të të dhënave dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore e teknologjike. Përputhshmëria me ESG-në, anëtarësimi me të drejta të plota në ENQA dhe regjistrimi në EQAR përbëjnë prioritete për njohjen evropiane të ASCAL-it. Ky orientim plotësohet nga procesi i aplikimit në CHEA, bashkëpunimi me agjencitë homologe dhe pjesëmarrja në rrjete e projekte ndërkombëtare.

Plani Strategjik 2026–2030 përcakton objektivat që orientojnë zhvillimin e ASCAL-it, duke lidhur misionin, vizionin dhe vlerat e saj me nevojat institucionale dhe zhvillimet në arsimin e lartë. Ai përqendrohet në cilësinë e proceseve të vlerësimit dhe monitorimit, kulturën e cilësisë dhe pjesëmarrjen, përdorimin e evidencave, transformimin digjital, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe qëndrueshmërinë institucionale. Zbatimi i objektivave do të konkretizohet në planet vjetore të veprimtarisë, ku do të përcaktohen aktivitetet, përgjegjësitë, burimet, treguesit dhe afatet, ndërsa progresi do të ndiqet përmes monitorimit dhe vlerësimit periodik.

02 / METODOLOGJIA

II. METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të Planit Strategjik 2026–2030 u mbështet në një qasje analitike dhe konsultuese, e cila ndërthuri vlerësimin e zhvillimit institucional të ASCAL-it me shqyrtimin e kërkesave kombëtare e evropiane në fushën e sigurimit të cilësisë dhe diskutimet e brendshme me stafin e Agjencisë. Gjetjet e analizës, të dhënat institucionale dhe përvoja e krijuar nga proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë shërbyen si bazë për përcaktimin e prioriteteve, objektivave, masave dhe treguesve të Planit.

Procesi u zhvillua në disa faza kryesore:

Faza I – Faza përgatitore

Në fazën përgatitore u përcaktuan qëllimi, struktura, fushat e analizës dhe mënyra e organizimit të procesit të hartimit të Planit. U identifikuan burimet kryesore të informacionit, dokumentet që do të shqyrtoheshin dhe çështjet institucionale që kërkonin trajtim strategjik.

Faza II – Analiza e situatës dhe e zhvillimit institucional

Kjo fazë u përqendrua në vlerësimin e situatës dhe zhvillimit institucional të ASCAL-it, duke përfshirë:

- shqyrtimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe strategjik të sigurimit të cilësisë;
- analizën e zhvillimeve dhe nevojave të sistemit shqiptar të arsimit të lartë;
- vlerësimin e kërkesave të ESG-ve dhe të kritereve e praktikave të lidhura me ENQA-n dhe EQAR-in;
- vlerësimin e funksionimit të procedurave, instrumenteve dhe sistemit elektronik të menaxhimit të proceseve;
- analizën e kapaciteteve njerëzore, financiare dhe teknologjike të Agjencisë;
- identifikimin e pikave të forta, fushave për përmirësim, mundësive dhe risqeve.

Gjetjet e kësaj faze shërbyen për përcaktimin e çështjeve prioritare që duhet të adresohen gjatë periudhës 2026–2030.

Faza III – Diskutimi dhe përcaktimi i prioriteteve strategjike

Në këtë fazë, gjetjet e analizës së situatës u diskutuan me stafin e ASCAL-it për të vlerësuar nevojat dhe problematikat institucionale, si dhe mundësitë për përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Diskutimet shërbyen për plotësimin dhe saktësimin e analizës dhe për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit institucional gjatë periudhës strategjike.

Mbi këtë bazë u përcaktuan objektivat strategjikë dhe masat përkatëse, duke marrë në konsideratë mandatin ligjor të ASCAL-it, kapacitetet institucionale, nevojat e sistemit të arsimit të lartë dhe kërkesat për përafrim evropian.

Faza IV – Rishikimi dhe finalizimi i Planit

Drafti i Planit iu nënshtrua një procesi rishikimi për të verifikuar koherencën ndërmjet kontekstit, analizës së situates dhe objektivave dhe masave. Në këtë fazë u shqyrtuan edhe qartësia e formulimeve, shmangia e mbivendosjeve dhe përputhshmëria e dokumentit me kërkesat kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë.

Plani është ndërtuar mbi parimet e realizueshmërisë, matshmërisë dhe llogaridhënies. Zbatimi i tij do të operacionalizohet nëpërmjet planeve vjetore të veprimtarisë, ndërsa progresi do të ndiqet përmes monitorimit periodik, vlerësimit vjetor, vlerësimit afatmesëm dhe vlerësimit përfundimtar.

III. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT

MISIONI

Misioni i ASCAL-it është të sigurojë, vlerësojë, monitorojë dhe promovojë cilësinë në arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet proceseve të pavarura, të paanshme, profesionale, transparente, proporcionale dhe të bazuara në standarde e evidenca të verifikueshme, duke mbrojtur interesin e studentëve, nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të institucioneve dhe programeve të studimit dhe mbështetur integrimin e plotë të sistemit shqiptar në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

VIZIONI 2030

ASCAL synon konsolidimin e saj si një agjenci e pavarur, e besueshme, profesionale, transparente dhe e njohur në nivel evropian e ndërkombëtar, e cila zbaton standardet dhe praktikat më të mira të sigurimit të jashtëm të cilësisë, mbështet zhvillimin e saj në përmirësimin e vazhdueshëm, inovacionin dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe analiza, nxit kulturën e cilësisë, mbron interesin e studentëve dhe kontribuon në zhvillimin e një sistemi të arsimit të lartë konkurrues, gjithëpërfshirës dhe të integruar në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

03 / VLERAT

3.1 Vlerat

Në ushtrimin e mandatit ligjor dhe në zhvillimin e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, ASCAL udhëhiqet nga parimet dhe vlerat institucionale të mëposhtme:

Pavarësia dhe paanshmëria

Hartimi dhe zbatimi i procedurave, përzgjedhja e ekspertëve dhe përgatitja e raporteve të vlerësimit në mënyrë të pavarur, objektive dhe të lirë nga ndikimet e papërshtatshme.

Integriteti dhe shmangia e konfliktit të interesit

Respektimi i standardeve etike dhe zbatimi i mekanizmave për deklarimin, parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesit në çdo fazë të procesit.

Profesionalizmi dhe përgjegjshmëria

Ushtrimi i përgjegjësive me kompetencë, korrektësi, objektivitet dhe brenda afateve të përcaktuara, duke garantuar cilësinë dhe konsistencën e proceseve dhe raporteve.

Transparenca dhe llogaridhënia

Sigurimi i informacionit të plotë, të saktë, të përditësuar dhe të aksesueshëm mbi standardet, procedurat, vendimet dhe rezultatet e vlerësimit, duke respektuar kufizimet ligjore për publikimin e informacionit.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

Ruajtja dhe përdorimi i informacionit të administruar gjatë proceseve vetëm për qëllimet e vlerësimit, në përputhje me kërkesat për konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit.

Objektiviteti dhe vendimmarrja e bazuar në evidenca

Mbështetja e vlerësimeve, gjetjeve dhe rekomandimeve në standarde të përcaktuara, të dhëna të besueshme dhe evidenca të dokumentuara e të verifikueshme.

Konsistenca dhe proporcionaliteti

Zbatimi i njëtrajtshëm i standardeve dhe procedurave, duke përshtatur fokusin dhe intensitetin e vlerësimit e monitorimit me natyrën, kompleksitetin dhe nivelin e riskut të secilit rast.

Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Sigurimi i përfshirjes kuptimplotë të studentëve, institucioneve të arsimit të lartë, ekspertëve dhe palëve të tjera të interesit, duke respektuar rolet dhe përgjegjësitë e secilit aktor.

Përmirësimi i vazhdueshëm

Përdorimi i rezultateve të vlerësimit, monitorimit, feedback-ut, analizave dhe vetëvlerësimit për përmirësimin e proceseve të ASCAL-it dhe nxitjen e kulturës së cilësisë në arsimin e lartë.

IV. KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR DHE STRATEGJIK

4.1 Kuadri kombëtar

Veprimtaria dhe orientimi strategjik i ASCAL-it mbështeten në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Aktet kryesore që përcaktojnë mandatin, organizimin, procedurat, transparencën dhe përgjegjshmërinë e Agjencisë janë:

- Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM nr. 109, datë 15.2.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar;
- VKM nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dhe Programi i Transparencës i ASCAL-it;
- Ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Legjislacioni në fuqi për sigurinë kibernetike, arkivat, dokumentet elektronike, rregullat e administrimit financiar, në masën që lidhen me veprimtarinë e ASCAL-it;
- Rregullorja e brendshme e ASCAL-it, Rregullorja e Bordit të Akreditimit, Manuali për procedurat e vlerësimit dhe akreditimit dhe politikat, kodet e procedurat e tjera të brendshme.

4.2 Kuadri evropian dhe ndërkombëtar

Në planin evropian, dokumenti orientohet nga Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG), kërkesat e ENQA-s për anëtarësim dhe të EQAR-it për regjistrim, si dhe angazhimet e Shqipërisë në EHEA. Përputhshmëria me ESG-në dhe vlerësimi i jashtëm ciklik përbëjnë bazën e prioritetit strategjik evropian të ASCAL-it. Bashkëpunimi me CHEA-n dhe me rrjete të tjera ndërkombëtare plotëson këtë orientim, duke zgjeruar shkëmbimin profesional, partneritetet dhe njohjen ndërkombëtare.

V. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE MASAT

01

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Konsolidimi i një sistemi të sigurimit të jashtëm të cilësisë, proporcional dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivi synon rritjen e besueshmërisë, konsistencës dhe efektivitetit të vlerësimit dhe monitorimit, në përputhje me kuadrin kombëtar dhe ESG-të. Ai përfshin rishikimin e standardeve pas miratimit të ESG-ve të ndryshuara, përmirësimin e procedurave dhe instrumenteve, përgatitjen dhe angazhimin e ekspertëve, rishikimin e metodologjisë së monitorimit pas akreditimit dhe qartësimin e mekanizmave të ankesave e apelimeve, në mbështetje të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

02

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Forcimi i kulturës së cilësisë dhe pjesëmarrjes së studentëve dhe palëve të interesit

Objektivi synon zhvillimin e kulturës së cilësisë dhe pjesëmarrjen aktive e gjithëpërfshirëse të studentëve dhe palëve të interesit. Ai përfshin mbështetjen e sistemeve të brendshme të cilësisë përmes trajnimeve, orientimeve dhe shkëmbimit të praktikave; përgatitjen dhe përfaqësimin e studentëve; përfshirjen e punëdhënësve dhe palëve të tjera përmes konsultimeve; rishikimin dhe zhvillimin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve dhe përdorimin e rezultateve të tij; si dhe organizimin e Konferencës Vjetore të Cilësisë si hapësirë dialogu. Këto angazhime mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm, duke respektuar përgjegjësinë parësore të IAL-ve për cilësinë.

V. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE MASAT

03

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

Zhvillimi i kapacitetit analitik dhe vendimmarrjes së bazuar në evidenca

Objektivi synon analizimin dhe përdorimin sistematik të të dhënave për identifikimin e tendencave, problematikave sistemike dhe praktikave të mira në arsimin e lartë. Ai përfshin hartimin dhe publikimin e analizave tematike e statistikore mbi rezultatet e vlerësimeve, monitorimeve e sondazheve, efektet e rekomandimeve dhe zhvillimet në arsimin e lartë; administrimin e instrumenteve të feedback-ut dhe analizimin e kontributit të aktorëve; si dhe përdorimin e përfundimeve për orientimin e planifikimit e vendimmarrjes dhe përcaktimin e ndjekjen e masave përmirësuese.

04

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Transformimi digjital dhe siguria e informacionit

Objektivi synon modernizimin e sistemeve digjitale dhe infrastrukturës teknologjike për administrimin, gjurmueshmërinë dhe raportimin më efikas të proceseve të ASCAL-it. Ai përfshin mirëmbajtjen dhe zhvillimin e AMS-së, mbështetjen e monitorimit, automatizimin e raportimit dhe ndërveprueshmërinë graduale me sistemet publike; përditësimin e pajisjeve dhe masave të sigurisë, vlerësimin e risqeve dhe sigurimin e vazhdimësisë së sistemeve; si dhe shqyrtimin e mundësive dhe përcaktimin e rregullave për përdorimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale, me mbikëqyrje njerëzore, verifikim të rezultateve dhe respektim të konfidencialitetit e mbrojtjes së të dhënave.

V. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE MASAT

05

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5

Përafrimi evropian dhe zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Objektivi synon konsolidimin e përputhshmërisë me ESG-të dhe zgjerimin e njohjes e bashkëpunimit ndërkombëtar të ASCAL-it. Ai përfshin përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e proceseve për anëtarësimin me të drejta të plota në ENQA, regjistrimin në EQAR dhe aplikimin në CHEA; adresimin e rekomandimeve të vlerësimeve ndërkombëtare; pjesëmarrjen në rrjete e aktivitete ndërkombëtare; si dhe zhvillimin e projekteve, aplikimeve të reja dhe partneriteteve me agjencitë homologe, duke përdorur përvojat e përfituara për përmirësimin institucional.

06

OBJEKTIVI STRATEGJIK 6

Forcimi i qeverisjes dhe kapaciteteve institucionale

Objektivi synon konsolidimin e qeverisjes, funksionimit efektiv dhe qëndrueshmërisë së ASCAL-it, duke ruajtur pavarësinë dhe integritetin institucional. Ai përfshin zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të njohurive; përmirësimin e politikës dhe praktikave të brendshme të cilësisë, vetëvlerësimin dhe përdorimin e feedback-ut; publikimin e informacionit të qartë e të aksesueshëm dhe përshtatjen e komunikimit me nevojat e studentëve, IAL-ve dhe publikut; si dhe planifikimin e administrimin e burimeve njerëzore, financiare, infrastrukturës dhe kushteve të punës për zbatimin e prioriteteve dhe vazhdimësinë e veprimtarisë.

VI. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RISHIKIMI

6.1 Planifikimi vjetor dhe burimet

Plani Strategjik zbatohet nëpërmjet planeve vjetore të veprimtarisë. Për çdo vit përcaktohen aktivitetet që kontribuojnë në objektivat dhe masat strategjike, strukturat përgjegjëse, afatet dhe treguesit. Planifikimi mbështetet në kapacitetet institucionale, Programin Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetin vjetor, si dhe në mundësitë e projekteve dhe asistencës teknike.

Afatet konkrete të aktiviteteve përcaktohen dhe përditësohen në planet vjetore. Proceset ndërkombëtare ndiqen sipas kërkesave dhe kalendarëve të organizatave përkatëse. Digjitalizimi, gjithëpërfshirja, pavarësia, integriteti dhe qëndrueshmëria merren në konsideratë në zbatimin e të gjithë objektivave.

6.1 Ndjekja e rezultateve

Strukturat përgjegjëse ndjekin dhe dokumentojnë realizimin e aktiviteteve të planeve vjetore të veprimtarisë dhe raportojnë kontributin e tyre në arritjen e objektivave strategjikë. Progresi i zbatimit të Planit vlerësohet përmes mekanizmave të mëposhtëm:

Mekanizmi i ndjekjes	Përmbajtja
Raportimi dhe vlerësimi vjetor	Vlerësimi i rezultateve kundrejt planifikimit vjetor dhe përdorimi i përfundimeve për përcaktimin e prioriteteve të vitit pasardhës.
Vlerësimi afatmesëm – 2028	Shqyrtimi i progresit drejt objektivave strategjikë, i burimeve dhe i risqeve, për të përcaktuar përshtatjet e nevojshme për periudhën 2029–2030.
Vlerësimi përfundimtar – 2030	Vlerësimi i arritjes së objektivave, i rezultateve dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe identifikimi i përvojave dhe prioriteteve për periudhën e ardhshme strategjike.

Përfundimet e monitorimit dhe vlerësimit përdoren për përmirësimin e zbatimit të Planit dhe përshtatjen e planifikimit vjetor me nevojat institucionale dhe zhvillimet ligjore e teknologjike. Kur nevojitet rishikimi i Planit Strategjik, ndryshimet dokumentohen dhe miratohen sipas procedurave përkatëse, duke ruajtur përputhjen me misionin dhe objektivat e ASCAL-it.